



Shkruan: Hysni Milloshi

## SHKON NJË VAJZË NË SHËTITORE

Zgjaten rrugët e Tiranës me blerimin që po zverdhet  
M'ua duk befasi kupë e qiellit se parreshtur do të derdhet,  
Sepse, drejt në shëtitore shkon një vajzë që t'ia err sytë,  
Derdhu kupë e qiellit derdhu, laja flokët e floringjtë.

Tremijë vjet e dashurova, tremijë vjet e kaq më shumë  
Nëpër halle, nëpër brenga veshur me barot e gunë  
Dhe ylberët ia kam kthyer kuaj krushqish natë e ditë  
Që ta hipja sipër tyre atë vajzë që t'ia err sytë.

Që të ishte nusja ime me duvak e pa duvak  
Ia kam ngjyer shpesh shaminë jo me bojë, po me gjak.  
Shkrinte akull borë e marsit, mbi humnera çelte prilli,  
Shpejt fustanin ia kam prerë me petale trëndafili.

Diellin mik të vjetër kisha dhe ky rreze më ka falë  
T'ia qëndisja dhe mitanin krejt me dritë e krejt me ar  
Dhe për sumbulla jeleku kam këputur yjet varg  
Në mesnatë të universit anembanë e pranë e larg.

Dhe tiran dhe engjëll bashkë unë kam qenë në dashuri  
Para saj jo s'më ka ndalur det e plumb e perëndi.  
Perënditë që vet krijova shtriga ferri kundër saj,  
I kam dashur dhe urryer nëpër tym e mjegullnajë.

Eshkën bukur ia kam ndezur shpirtit tim kreshnik në kreshta.  
Tremijë dimra për të çarë vetëm sa të vijë vjeshta.  
Nëpër dimrat fort të gjatë ngrinin krushqit prapa malit,  
Ç'bukuri e tmerrshme mbetej ngrirë mbi samar të kalit!

N'zjarr të shpresës gjakun ngroha nusen time që ta çngrija.  
Dhe në pritjen për dy jetë me një djep malor i rrija,  
Me një djep e një parmendë e një zemër sakatuar,  
Që herë bëhej zog i kaltër, herë më nxinte varr në duar.

Kur në buzë të jetës qeshte mrekullisht një curril dritë,  
Porsi qielli mbi dëborë para meje hapte gjijtë,  
Si dy diej të bardhë ata vezullorë në sy më rrinin,  
Njëri gurgullonte Vjosën, tjetri gurgullonte Drinin.

Gjaku im në plis të fjalës iu bë vlagë ligjërimit,  
Horizontet duke mbjellur veç me farën e blerimit,  
Gjak i hijshëm art gatuar derdhej bust e poezi,  
Toka, yjet, deti, retë sa s'ua çartën në zili.

Mençurinë e dheut krejt mbloodha në një fjalë shqipe,  
Që dhe globin në pëllëmbë e peshonte rruzull drite.  
O fisnike i kam thirrur, me një zë kristal gjeniu  
Sa dhe era ngriu malit në mermer e më nuk shkriu.

Dhe ullinjtë jetëgjatë më dëgjuan e bleruan  
Dhe për nderin e fisnikes kurrë më s' u thinjëruan.  
Po në turret tërbimit tej shkretëtirash vinin retë,  
Mbi mëngjeset e fisnikes s' hodhën shi po ferexhetë.

Dashuria shkulte bjeshkët sytë e bukur për t'ia parë,  
Buzë e faqe për t'ia puthur ku çel molla në një arë.  
Po mëngjesit brenda natës s' kish det hallet për t'ia qarë,  
Bubullinte mall i fshehtë rrokullim – ortek i bardhë.

Sipër shpirtit, dyqind okësh, gurin kur e vija unë,  
Ajo vinte pa u ndier e ma shkrinte mu në gjumë.  
Bash me ballë të zemrës sime rashë mbi prangat e qelitë  
T' i shpërtheja, t' i gremisja mu në hon të pakufijtë.

Në kështjellën e ngujimit prita, prita mijëra vjet  
Kur do vijë një ditë e bardhë të më flas e t' i flas vetë!  
Kur do vijë një ditë e lirë që të ecim pranë e pranë  
Era mos na inçizojë si spiune zërat tanë?

Koha rrodhi, dogja pranga, ajo qeshi, qeshi jeta,  
Unë sot zemrën si kordele ia lidhë vajzës mbi gërsheta.  
Dal në rrugë e dal në parqe pa u fshehur nga vështrimet,  
Në sytë tanë si dritë dasme çelërojnë gjithë agimet.

Mbushur ag e hapësirë ia rrëmbej epokës penën  
Brenda në kimi të bojës thërmoj yjet edhe Hënën,  
Gjethet, lulet, vetëtimat, dritën, vesën e zambakut,  
Shtatë gurgullima krojesh dhe të kuqen ndezur gjakut.

Prej kur doli kësaj ore me brilante djerse larë,  
Që nga syri i madh i ditës, apo gjiri i saj i bardhë?  
Jo, mor jo , që prej uzinës me një karafil në dorë.  
Male shkuluni me rrënjë, të më vini si dasmorë.

Ja tek ecën përmbi vjeshtë me bilbilat përmbi vetull  
Që këndojnë veç për mua papushim e të patretur.  
Yll e dritë nga syri i saj marrin vetë kaltërsitë,  
Qesh një dhëndër, qesh një nuse në Tiranën e florinjëtë.